

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

PROJEKTENDIM

Nr. \_\_\_\_/2018

**“PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË PAVARUR PËR KOORDINIMIN,  
MONITORIMIN DHE NDJEKJEN E ZBATIMIT TË LIGJIT  
NR. 115/2016 “PËR ORGANET E QEVERISJES SË SISTEMIT TË DREJTËSISË”**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1 të Kushtetutës, nenit 288 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” dhe të nenit 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e një grupi deputetësh,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**I.** Ngrihet Komisioni i Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e zbatimit të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” (në vazhdim “Komisioni i Pavarur”).

**II.** Komisioni i Pavarur ka për detyrë:

- a) të monitorojë proceset e përzgjedhjes së kandidatëve dhe të zgjedhjes dhe emërimit të anëtarëve të organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë;
- b) të bëjë koordinimin midis institucioneve dhe organeve që zbatojnë ligjin nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”;
- c) të ndjekë ecurinë e zbatimit të parashikimeve të ligjit nr. 115/2016 (në vijim “ligji nr.115/2016”), nga institucionet respektive të parashikuara në këtë ligj, brenda afateve të përcaktuara ligjore;
- ç) të raportojë në komisionin e përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend për ecurinë e zbatimit të ligjit, sa herë është e nevojshme dhe kërkohet prej tij;
- d) të raportojë në Kuvend, për ecurinë e zbatimit të ligjit, sa herë kërkohet prej tij.

**III.** Komisioni i Pavarur përbëhet nga 5 anëtarë, që zgjidhen nga Kuvendi me votim të fshehtë, me shumicë të thjeshtë, nga lista e kandidatëve e miratuar në komisionin e përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend.

Komisioni i Pavarur i ushtron funksionet e tij deri në përfundimin e procesit të krijimit dhe fillimin e veprimtarisë së organeve të parashikuara në ligjin nr.115/2016.

**IV.** Komisioni i Pavarur drejtohet nga kryetari, i cili zgjidhet në mbledhjen e parë të Komisionit, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të tij. Në mbledhjen e parë të Komisionit të Pavarur zgjidhet dhe sekretari i tij, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të Komisionit. Sekretari drejton çështjet administrative - teknike të komisionit dhe, së bashku me Kryetarin, mban marrëdhëniet administrative me stafin mbështetës, ndjek mbarëvajtjen e procedurave për organizimin e mbledhjeve si dhe kujdeset për ruajtjen dhe administrimin e dokumentacionit të Komisionit të Pavarur, sipas legjislacionit në fuqi. Anëtari më i vjetër në moshë përgatit dhe thërret mbledhjen e parë të Komisionit të Pavarur, jo më vonë se 3 ditë pas datës së hyrjes në fuqi të vendimit të Kuvendit për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur.

**V.** Kriteret dhe kushtet për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur janë si më poshtë:

1. Anëtar i Komisionit të Pavarur mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:
  - a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
  - b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;
  - c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;
  - ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;
  - d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1, duhet të plotësojë edhe këto kritere:
  - a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet pune në profesionin jurist, gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, apo jurist i nivelit të lartë në administratën publike;
  - b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës;
  - c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.
3. Plotësimi i kritereve të mësipërme vlerësohet në bazë të:
  - a) vjetërsisë në profesion;
  - b) përvojës së veçantë të kandidatit në një fushë të caktuar të së drejtës;
  - c) kualifikimeve pasuniversitare dhe trajnimeve në fushën e të drejtës;
  - ç) treguesve shkencorë, ku përfshihen botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike;

**VI.** Komisioni i Pavarur mbledhet të paktën 1 herë në muaj. Mbledhjet janë të vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të Komisionit. Vendimet e Komisionit quhen të miratuara me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve.

**VII.** Komisioni i Pavarur miraton rregulloren e brendshme të organizimit dhe të veprimtarisë së tij duke iu referuar legjislacionit në fuqi për funksionimin e organeve kolegjiale.

**VIII.** Komisioni i Pavarur, për ushtrimin e funksioneve të tij ndihmohet nga administrata e Kuvendit.

**IX.** Masa e shpërblimit për pjesëmarrje në mbledhjet e komisionit caktohet nga Byroja e Kuvendit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**X.** Brenda 5 ditëve nga miratimi i këtij vendimi, Kuvendi publikon në faqen zyrtare në internet njoftimin për hapjen e procedurës së aplikimit për kandidatët për anëtarë të Komisionit të Pavarur, duke përcaktuar një afat 10 ditor për dorëzimin e aplikimit. Lista e kandidatëve që kanë shprehur interesin për t'u zgjedhur publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit.

**XI.** Komisioni përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend, brenda tre ditëve nga publikimi i listës, zhvillon një seancë dëgjimore publike për të bërë vlerësimin e meritës së kandidatëve dhe të përmbushjes së kushteve dhe kriterëve për t'u zgjedhur. Komisioni përgjegjës për çështjet ligjore, brenda 1 jave nga përfundimi i seancës dëgjimore, përmes një procedure votimi të hapur, ku votohet me radhë për të gjithë kandidatët, miraton listën me jo më pak se 7 dhe jo më shumë se 10 kandidatë, si dhe harton një raport mbi vlerësimin e kandidatëve.

**XII.** Raporti i vlerësimit dhe lista e kandidatëve për votim i përcillen menjëherë Kuvendit në seancë plenare. Në përfundim të procesit të votimit, konsiderohen të zgjedhur pesë kandidatët që kanë marrë më shumë vota. Në rast barazie të votave, anëtari përzgjidhet me short manual.

**XIII.** Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar më \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /2018.

**KRYETARI**

**GRAMOZ RUÇI**

## RELACION

### PËR PROJEKTVENDIMIN “PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË PAVARUR PËR KOORDINIMIN, MONITORIMIN DHE NDJEKJEN E ZBATIMIT TË LIGJIT NR. 115/2016 “PËR ORGANET E QEVERISJES SË SISTEMIT TË DREJTËSISË”

Zbatimi i reformës në drejtësi është një nga prioritetet e punës së Kuvendit të Shqipërisë, në përmbushje të funksioneve të tij kushtetuese dhe ligjvënëse. Një nga ligjet prioritare të reformës, ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, parashikon në nenin 288 detyrimin e Kuvendit për të ngritur një komision të pavarur për monitorimin e proceseve të përzgjedhjes së kandidatëve dhe të zgjedhjes së emërimit të anëtarëve të organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë.

Ky komision do të bëjë koordinimin midis institucioneve dhe organeve që zbatojnë parashikimet ligjore të ligjit 115/2016, si dhe do të ndjekë ecurinë e zbatimit të parashikimeve ligjore nga institucionet respektive, të parashikuara në ligj, brenda afateve ligjore të parashikuara.

Ecuria dhe dinamika e reformës në drejtësi, si dhe problematika e hasur deri tani gjatë zbatimit të saj, e bëjnë të domosdoshëm krijimin sa më shpejt të këtij komisioni, për arsyet e mëposhtme:

*Së pari:* Ligji “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, parashikon ngritjen dhe funksionimin e shumë institucioneve të reja me rëndësi, ose riformatim të institucioneve ekzistuese që kanë përgjegjësi për qeverisjen e sistemit të drejtësisë. Ngritja ose riorganizimi i tyre bëhet nëpërmjet një procedure të detajuar në ligj dhe me përfshirjen e një sërë institucionesh.

*Së dyti:* Procedura e krijimit të institucioneve të reja përfshin disa organe dhe çdo fazë e kësaj procedure parashikohet të kryhet brenda afateve ligjore të mirëpërcaktuara që duhet të respektohen nga secili institucion, sipas parashikimeve të bëra në këtë ligj. Moszbatimi i afateve dhe procedurave konkrete, qoftë nga një institucion ndikon në ecurinë dhe mbarëvajtjen e gjithë procesit të zbatimit me sukses të reformës në drejtësi.

*Së treti:* Zbatimi i këtij ligji kushtëzon zbatimin e ligjeve të tjera, duke përfshirë gjithë reformën në drejtësi. Ne jemi të mendimit se reforma në drejtësi do të jetë efektive jo vetëm me miratimin e ligjeve, por edhe me zbatimin e tyre në kohë.

*Së katërti:* Ligji parashikon detyra dhe përgjegjësi të mirëpërcaktuara për një sërë institucionesh të pushtetit legjislativ, ekzekutiv, gjyqësor, institucionet e pavarura, institucionet e tjera të krijuara me ligj ose organet e administratës shtetërore, në procesin për krijimin e institucioneve të reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë. Bashkëveprimi dhe koordinimi i institucioneve me njëri-tjetrin për të bërë të mundur zbatimin e ligjit ka nevojë të monitorohet dhe mundësohet me gjithë mbështetjen ligjore, financiare dhe logjistike të nevojshme.


Komisioni i Pavarur do të evidentojë rastet kur institucionet përgjegjëse nuk zbatojnë ligjin brenda afatit dhe nuk kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara, duke ia bërë me dije komisionit të përhershëm përgjegjës

për çështjet ligjore, ose drejtpërdrejt Kuvendit, nëpërmjet raportimit, me qëllim që të mund t' i propozohet Kuvendit marrja e masave përkatëse për moszbatimin e ligjit.

Duke mbajtur parasysh sa më sipër, si dhe vetë emërtesën, komisioni është konceptuar si një organ kolegjal, i përbërë nga profesionistë të fushës. Kuvendi në aspektin procedural e krijon këtë komision bazuar në dispozitat e parashikuara në rregulloren e tij.

Në përfundim, për sa më sipër, propozohet projektvendimi "Për ngritjen e komisionit të pavarur për koordinimin, monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i cili rregullon përbërjen e Komisionit, kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve, mënyrën e funksionimit si dhe detyrat e komisionit.

**DEPUTETË PROPOZUES**

LILSI MANJA 

KLOJLLA BUSHKA (FORNATI) 